

Përgjigje dhe korigjim

Me qëllim që të qartësohet mënyra dhe kushtet për realizimin e së drejtës për përgjigje dhe korigjim nga ana e personave fizik dhe juridik, që konsiderojnë se u është dëmtuar reputacioni, nderi, interesat duke publikuar informata të pasakta, të gabuara, të rrejshme ose jo të plota në lidhje me ta, nga ana e medimeve, Agjencia botoi një fletushkë “Përgjigja dhe korigjimi i informatave të pasakta, të gabuara, të rrejshme ose jo të plota,,.

Fletushka i dedikohet opinionit të gjërë dhe i njëjti mund të merret në këtë [link](#).

Plani për popullarizimin e të drejtës për përgjigje dhe korigjim



Kjo është pasqyrim i thjeshtësuar i dispozitave me të cilat rregullohet e drejta e korigjimit dhe përgjigjes. Kjo problematikë është në detale e rregulluar me Ligjin për mediet, në nenet prej 17 deri 28. Ligji është në dispozicion në ueb adresën e ASHMAV, në pjesën LEGJISLATURA

KUSH ka të drejtë që të kërkojë nga ndonjë medium që të publikojë korigjim ose përgjigje?



Secili që konsideron se mediumi i ka prekur dinjitetin, nderin, interesat duke publikuar:

- Diçka të pasaktë, gabim ose rrejshëm për të,
- informatë jo të plotë në lidhje me të.

Kush parashtron
kërkesë për
korrigjim ose
përgjigje në emër të
një **PERSONI TË
VDEKUR?**



Fëmijët, fëmijët e adoptuar, bashkëshorti/ja,
adoptuesit, vëllezërit/motrat ose persona
juridik, nëse informata ka të bëjë me
veprimtarinë e të ndjerit në lidhje me atë
person juridik.

SA kushton që
të publikohet një
korrigjim ose
përgjigje?



Korrigjimi ose përgjigja publikohen pa kompensim.

KUR kërkoni
që të
publikohet një
korrigjim?



Atëherë kur doni që të korrigjoni të dhëna të gabuara ose
të pasakta, ose që të publikohen fakte ose rrethana me të
cilat përgënjeshtrohen intencat e rrejshme ose ato
plotësohen në kuadër të informatës që e ka publikuar
paraprakisht mediumi.

SI kërkohet publikimi i korrjimit ose përgjigjet?



Kërkesa dërgohet deri te mediumi në formë të shkruar.

DERI TE KUSH
parashtrohet kërkesa për korrjzim ose përgjigje?



Deri te redaktori përgjegjës i publikuesit të mediumit që e ka publikuar dezinformatën.

NË ÇFARË AFATI
parashtrohet kërkesa për korrjzim ose përgjigje?



Në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të dezinformatës.

ÇKA duhet të përmbajë kërkesa?



- cila informatë ose cilat të dhëna korrigojnë, respektivisht për cilat reagojnë.
- teksti ose porositja të jetë e natyrës së njëjtë dhe me gjatësi të njëjtë sikur informata e publikuar, respektivisht ajo nuk guxon që të jetë më e gjatë në raport me informatën, respektivisht nga pjesa e informatës në fjalë.
- kërkesa të arsyetohet, me të gjitha të dhënat e nevojshme, me adresë dhe nënshkrimin e parashtruesit.

KUR më së voni duhet që mediumi ta publikojë korrigjimin/përgjigjen?



Në afat prej dy ditëve pas dorëzimit të kërkesës. Në rast të zgjedhjeve, publikimi është në programin e parë të atij lloji menjëherë pas pranimit të kërkesës.

KU duhet të publikohet korrigjimi/përgjigja?



Lexohet në të njëjtin programi ose termin, ose në program të ngjashëm me nivel të njëjtë të shikueshmërisë ose dëgjueshmërisë si ajo ku është publikuar informata për të cilën reagojnë.

SI duhet të publikohet korrighimi/ përgjigja?



Publikohet pa ndryshime ose plotësime, me ç'rast mediumi nuk guxon që ta komentojë ose ti përgjigjet konstatimeve në të dhe që nga titulli duhet të jetë e qartë se bëhet fjalë për korrighim. Për çfarëdo ndryshimi patjetër duhet të kërkohet pëlqim nga parashtruesi (mund të përmirësohen vetëm gabimet drejtshkrimore).

VALLË

korrighimi guxon që të publikohet gjatë reagimeve të shikuesve ose dëgjuesve?



Vetëm nëse parashtruesi pajtohet me atë.


NË CILIN RAST mediumi ka të drejtë që të mos publikohet korrighim ose përgjigje?



- Nëse nuk ka të bëjë me informatën në të cilën thirret personi, - Nuk përmban të dhëna në lidhje me konstatimet në informatë,
- Është në kundërshtim me interesat e mbrojtura me ligj të personave të tretë,
- Kërkesa për publikimin e korrighimit nuk është e nënshkruar nga parashtruesi ose nga personi i autorizuar i organit shtetëror ose personit juridik,
- Proporcionalisht është më e madhe, përveç nëse ka të bëjë me shpifje ose informatë me përmbajtje ofenduese,
- Është shkruar në gjuhë që nuk është identike me atë të informatës së publikuar,
- Nëse bëhet fjalë për kritikë shkencore ose artistike, përveç nëse korrighohen të dhëna të pasakta, ofenduese ose tendencioze,
- Veç më është kërkuar korrighim/përgjigje të përmbajtjes së njëjtë ose nëse ka kontest për shkak të mospublikimit të korrighimit,
- Publikuesi i mediumit veç më ka publikuar vetë një korrighim të informatës së publikuar, - Kërkesa është parashtruar 30 ditë pas publikimit,
- Përmban ofendim ose shpifje.

VALLË

ekzistojnë raste tjera ku redaktori përgjegjës mund të refuzojë të publikojë përgjigje?




PO, atëherë kur informata e publikuar është pjesë e një raporti të besueshëm nga seancat publike të organeve dhe gjykatave shtetërore; kur theksohen të dhëna ose pohime dukshëm të pasakta, si dhe konstatime tjera që janë bindshëm të papërshtatshme për dëshmim.

Si do ta dijë parashtruesi se pse nuk është publikuar korrigjimi/ përgjigja.



Redaktori përgjegjës duhet patjetër ta njoftojë me shkrim parashtruesin për arsyen për mos publikim në afat prej dy ditëve nga parashtrimi (gjatë zgjedhjeve – menjëherë pas pranimit të korrigjimit).

ÇKA nëse redaktori konsideron se vetëm një pjesë e të dhënave ose pohimeve janë të pasakta ose të papërshtatshme për dëshmim?



Ai nuk guxon që të refuzojë publikimin e përgjigjes pa kërkuar paraprakisht nga parashtruesi i kërkesës që ti heq nga përgjigja ato të dhëna dhe konstatime.

VALLË
mund të
shkurtohet
përgjigja?



Redaktori përgjegjës ka të drejtë që të kërkojë nga parashtruesi i kërkesës që të shkurtojë përgjigjen para se ta publikojë.

ÇFARË bëhet
nëse një medium
publikon se kundër
dikujt është
parashtruar padi
penale ose që ka
filluar procedurë
hetimore ose penale?



Pasi që të hidhet poshtë padia penale, do të ndërpritet procedura hetimore ose penale ose do të miratohet aktvendim i plotfuqishëm për lirim, personi në fjalë mundet që në afat prej tre muajve të kërkojë nga redaktori përgjegjës ta publikojë informatën, me ç'rast duhet të vlejné të njëjtat rregulla sikur për secilën përgjigje, respektivisht korrigjim.

ÇFARË të
bëhet nëse
mediumi në
ndërkohë ka
pushuar së
ekzistuari?



Parashtruesi mund të kërkojë që të publikohet korrigjim ose përgjigje në barrë të publikuesit të mediumit te ndonjë radiodifuzer tjetër, të ngjashëm për nga shikueshmëria, respektivisht dëgjueshmëria.

VALLË mund të kërkohet incizim/ kopje nga informata e publikuar?



Po, edhe atë incizim mediumi është i obliguar që t'ia sigurojë personit të interesuar (në shpenzim të tij) në afat prej 3 ditëve nga pranimi i kërkesës me shkrim. Personi i interesuar mund ta shfrytëzojë kopjen vetëm për përdorim personal dhe nuk guxon që ta publikojë pa pëlqimin e mediumit, përveç në procedurë gjyqësore. Nëse radiodifuzeri nuk ka kopje, konsiderohet se e ka publikuar informatën për të cilën kërkohet përgjigje ose korrigjim.

SA kohë duhet që të ruhet incizimi i informatës së publikuar?



Nëse në afat prej 8 ditëve nga publikimi i ndonjë informate, mediumi njoftohet se do të kërkohet që të publikohet korrigjim/përgjigje, redaktori përgjegjës është i obliguar që të ruaj incizim deri sa të publikohet korrigjimi/përgjigja, respektivisht deri sa të përfundojë rasti gjyqësor ose deri sa të skadojnë afatet e përcaktuara ligjore për realizimin e së drejtës.

ÇFARË nëse mediumi nuk e publikon korrigjimin/ përgjigjen ose e ka publikuar (në mënyrë të pavarur ose me kërkesë), por në **MËNYRË JOADEKUATE** ose jashtë afatit të përcaktuar?



Mund të ngritët padi kundër redaktorit përgjegjës para gjykatës kompetente.

Në cilin AFAT
NGRITËT padia?



Në afat prej 30 ditëve pas skadimit të afatit për publikimin e korrigjimit, respektivisht nga dita kur korrigjimi nuk është publikuar ose ka qenë e publikuar në mënyrë që nuk përshtatet me ligjin për mediet.

Në çfarë AFATI
ZGJIDHEN
kontestet?



Kontestet gjyqësore për korrigjim/përgjigje zgjidhen me procedurë urgjente.

Çfarë të bëhet nëse
NDËRROHET REDAKTORI
përgjegjës, pasi që është
ngritur padia kundër
mediumit?



Paditësi ka të drejtë që ta padis redaktorin e ri, pa pëlqim të redaktorit të ri ose atij të mëparshëm.

Sa janë DËNIMET
që mund ti
shqiptojë gjykata?



Gjobë – prej 1.500 deri në 3.000 € për personin juridik dhe prej 500 deri në 1.000 € për personin përgjegjës (në kundërvlerë të denarit).

Çfarë ndodh
pasi që paditësi
do ta FITOJË
KONTESTIN?



Redaktori përgjegjës është i obliguar që ta publikojë
korrigjimin/përgjigjen pas përfundimit të procedurës
gjqësore dhe të theksojë se publikimi bëhet në bazë
të aktvendimit të plotfuqishëm gjyqësor me ç'rast
është i obliguar që ta citojë aktgjykimin e shqiptuar.

Plani për popularizimin e së drejtës për përgjigje dhe
korigjim